



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA			
Pranuar · Prilapitur Me Datë 20-06-2026			
Nr. Dokument Op. Reg.	Nomeni Reg.	Shkruar Pikëz	Vlera Vrednost
07	170/05-659		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2026 miraton këtë:

V E N D I M

për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2027

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi Komunal i Vitisë miraton vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.

Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

- | | |
|------------------------|----------------------------------|
| 1. z.Bekim Azizi | Kryesues i Kuvendit Komunal |
| 2. z.Basri Aliu | Përfaqësues i GP i LDK-së; |
| 3. zn.Lindita Demelezi | Përfaqësues i GP i VV-së; |
| 4. zn. Elsa Jahija | Përfaqësues i GP i PDK-së; |
| 5. z.Labinot Bislimi | Këshilltar Komunal nga AAK-ja; |
| 6. z.Fatlum Demiri | Sekretaria e Kuvendit; |
| 7. zn.Albulena Selmani | Përfaqësues nga shoqëria civile. |

Neni 2

Grupi punues, konform nenit 1 të këtij vendimi, në konsultim me Kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2027, dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.

Neni 3

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbaj objektivat dhe qëllimet e Kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe komiteteve obligative dhe funksionale të kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara.

Neni 4

Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komuna dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit;

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi